



BËHU PRONAR I TOKËS TËNDE!

Nuk jeni të pajisur me tapinë / aktin e marrjes së tokës bujqësore në pronësi (AMTP)

Drejtohuni te Bashkia juaj ku do të paraqisni:

- 01 Kërkesën;
- 02 Planvendosjen e ngastrës/ngastrave;
- 03 Certifikatën familjare sipas regjistrit të gjendjes civile të datës:
 - 1.08.1991, për territoret e ish kooperativave bujqësore;
 - 1.08.1991 me ndryshime deri më 1.10.1992, për territoret e ish ndërmarrjeve bujqësore;
- 04 AMT në përdorim (nëse e dispononi, për territoret e ish ndërmarrjeve bujqësore);
- 05 Dokumentacionin që vërteton se jeni përfitues me tokë si rezultat i levizjes nga qendra juaj e banimit, me VKM të veçanta.

Nëse keni përfituar tokë bujqësore si bashkëthemelues të ish-Ndërmarrjeve Bujqësore, duhet të paraqisni:

- 01 Kërkesën;
- 02 Dokumentacion kadastral, hipotekor, arkivor apo gjyqësor që provon pronësinë mbi tokën bujqësore
- 03 Planvendosjen e ngastrës/ngastrave;
- 04 Certifikatën familjare në momentin e dorëzimit të tokës bujqësore e shoqëruar me aktet e trashëgimisë.
- 05 AMT në përdorim (nëse e dispononi)

Ky proces kryhet deri më datë 31.12.2018

Çfarë përfitoni nëse pajisni me certifikatën e pronësisë për tokën bujqësore?

- 01 Mund të përfitoni nga programet e ndihmës shtetërore për bujqësinë;
- 02 Mund të shisni tokën në pronësinë tuaj;
- 03 Mund ta jepni me qira
- 04 Mund ta ndani ose ta shkëmbeni;
- 05 Mund ta lini në trashëgimi
- 06 Keni lehtësira në marrjen e kredive nga bankat;
- 07 Mund të zhvilloni pronën tuaj në përputhje me studimet e ndryshme që organizmat shtetëror mund të planifikojë për zonën në të cilën ndodhet kjo pasuri;
- 08 Te ardhurat e përfituara nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore nga një fermer i regjistruar te një fermer tjetër, apo person fizik a juridik që kryen aktivitet bujqësor, janë të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat personale.

